

Seancës Plenare
21/11/2022

KUVENDI
NR. 3882 DATE 18.11.22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____, 2022

Lënda: Propozohet një projektligj për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi.

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit

Tiranë

Znj. Kryetare,

Në mbështetje të Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëngjitur do të gjeni projektligjin “Për një ndryshim dhe shtesë në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, të shoqëruar me relacionin e tij.

Kjo nismë ligjvënëse vjen si propozim nga një grup deputetësh të Partisë Demokratike të Shqipërisë, nënshkrimet e të cilëve do t'i gjeni bashkëngjitur.




















Në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, kërkojmë nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin sa më parë të këtij projektligji nga Kuvendi i Shqipërisë.


Duke ju falenderuar,

GRUPI I DEPUTETËVE

Sorli Basha
President

DEPUTETËT

1. Ina Zhupa 
2. AGROU SHENAJ 
Albana Vohu 
3. Edmond Spaho 
4. Elda Hoti 
5. Xhelal Azizi 
6. BELIND KENICAJ 
7. EDI PALOKA 
8. WILSON BOG 
9. Dora Bylybooshi 
10. Jona Koto 
11. Duam Baci 
12. Lindita Medaritaj 
13. Izaj Cepur 
14. Krasem Vahmetaj 
15. Zetra Besli 
16. Shemsi Nohu 
17. Sok Bushku 
18. Triton Shela 



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____, datë _____ 2022

PËR

**NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995
“KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 pika 1, 81 pika 2 dhe 83 pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 67, të titulluar “Mosparashkrimi i ndjekjes penale”, pas fjalisë, “Nuk i nënshtrohen parashkrimit të ndjekjes penale krimet e luftës dhe ato kundër njerëzimit”, të shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Nuk i nënshtrohen parashkrimit, veprat penale dhe akuzat penale të korrupsionit dhe të krimet të organizuar, kundër Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, Ministrit, Kryetarit të Kuvendit, Kryetarit të Bashkisë Tiranë, drejtuesit e institucioneve qendrore përgjegjëse për prokurimet publike dhe koncesionet, si dhe ish-funksionarëve të sipërpërmendur. Kjo dispozitë i shtrin efektet e saj deri në datë 31.12.2037”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995 "KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji synon të ofrojë transparencën maksimale ndaj publikut por edhe ndaj organeve ligjzbatuese, për sa i përket hetimit dhe gjykimit të krimeve të korrupsionit apo të krimit të organizuar që mund të jenë kryer në të shkuarën nga politikanë apo zyrtarë të lartë. Ky qëllim mund të arrihet duke hequr çdo pengesë ligjore për hetimin e krimeve të korrupsionit apo krimit të organizuar që mund të jenë kryer nga funksionarët më të lartë të Shtetit, si Kryetar Kuvendi, Kryeministër, Zëvendëskryeministër, Ministrat, drejtuesit e institucioneve qendrore përgjegjëse për prokurimet publike dhe koncesionet, si dhe ish-funksionarëve të sipërpërmendur.

Me miratimin e këtij Projektligji dhe përfshirjen e dispozitave të tij në Kodin Penal, nuk do të ketë më asnjë politikan apo zyrtarë të lartë që do mund të fshihet pas mburojës juridike të konceptit të parashkrimit, i cili konsiston në shuarjen e mundësisë për ndjekje penale, pas kalimit të një afati kohor të caktuar nga çasti i ngjarjes apo i veprës penale.

Në raste të caktuara, lidhur me afëra apo skandale të bëra publike, është vënë re se hetimet janë mbyllur për shkak të parashkrimit, pra thjesht për shkak sepse kishte kaluar një kohë e gjatë nga momenti kur pretendohet që ishin kryer veprat penale në fjalë. Ndërkohë ato çështje nuk janë paraqitur dot në gjykim dhe asnjë institucion i drejtësisë nuk e ka patur dot të mundur të shprehet lidhur me thelbin, për të kuptuar nëse vërtetë kishte patur apo jo shkelje ligjore nga ana e politikanit apo zyrtarit të përfshirë.

Në kushtet kur niveli i korrupsionit dhe i krimit të organizuar në vend vijon të mbetet alarmant, e konstatuar kjo përditë nga qytetarët shqiptarë, por edhe e konfirmuar vit pas viti nga shumë raporte serioze ndërkombëtare, përfshirë raportin e fundit të Departamentit të Shtetit Amerikan (DASH), gjykojmë se është e domosdoshme që politikanët dhe zyrtarët e lartë shqiptarë të pranojnë të heqin dorë nga mbrojtja ligjore që u jep koncepti juridik i parashkrimit.

Vetë ky raport i DASH, i publikuar më herët gjatë vitit 2022 thekson qartë se: *"Ndërsa prokurorët bënë përparim të rëndësishëm në ndjekjen e rasteve të korrupsionit publik të nivelit të ulët dhe të mesëm, shkalla e ndjekjes penale për zyrtarët e rangut të lartë mbeti e ulët"*. Po ashtu, projekt-raporti i Komisionit Europian për Shqipërinë, i publikuar ditët e fundit, evidenton korrupsionin e nivelit të lartë dhe politik.

Në këtë kontekst, ndryshimet ligjore të propozuara që synojnë të heqin parashkrimin për krimet e korrupsionit dhe ato të krimit të organizuar, gjykojmë se janë të domosdoshme në mënyrë që politikanët të dëshmojnë se nuk fshihen pas procedurave juridike, por të angazhohet për më tepër transparencë dhe llogaridhënie.

II. VLËRËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik të projektakteve, por ai vjen si nismë e një grupi deputetesh të opozitës, me qëllim heqjen e parashkrimit për ndjekjen penale të akuzave për krime të sferës së korrupsionit apo të krimit të organizuar, që mund të ngrihen ndaj drejtuesve të lartë të shtetit apo ish-drejtuesit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përparësia e Projektligjit, sikundër rezulton dhe nga përmbajtja e nenit 1 të tij, është që të hiqen pengesat procedurale të parashkrimit dhe rrjedhimisht të hapet mundësia e ndjekjes penale për ngjarje të cilat mund të kenë ndodhur shumë vite më parë. Kategoria e personave të prekur drejtëpërdrejtë nga kjo nismë janë disa nga zyrtarët më të lartë dhe ish-zyrtarët më të lartë të shtetit shqiptar.

Sikundër e përmendëm edhe më sipër, problematika e korrupsionit në Shqipëri vijon të mbetet shqetësuese. Ky fenomen është gjerësisht i përhapur në shoqëri, por veçanërisht shqetësues po kthehet korrupsioni në nivelet e larta të qeverisjes.

Mjaft afëra janë denoncuar prej vitesh nga opozita apo mediat investigative, por hetimet ndaj përgjegjësve realë kanë çaluar, duke u zvarritur për vite me rradhë deri në pikën kur kalonin afatet e parashkrimit dhe nuk ishte më e mundur ushtrimi i ndjekjes penale. Kjo për shkak sepse parimet e Kodit Penal parashikojnë sot ndalimin e ushtrimit të ndjekes penale pasi kalon një afat kohor i përcaktuar. Parashkrimi si koncept juridik i shërben parimit të sigurisë juridike dhe ai sot zbatohet njësoj për të gjithë qytetarët shqiptarë, pa asnjë dallim.

Por, në kushtet kur korrupsioni në nivelet e larta të qeverisjes sa vjen e bëhet më shqetësues, propozojmë diferencimin e kategorisë së politikanëve dhe zyrtarëve të lartë, që kanë, apo kanë mbajtur poste të larta shtetërore, duke i trajtuar këta të fundit me një shkallë mbrojtjeje më të ulët sesa qytetarët e zakonshëm.

Efektet e pritshme të kësaj nisme do të jenë të prekshme. Së pari, kjo do pengonte mbylljen e hetimit për shkak parashkrimi të dosjeve që po hetohen aktualisht nga institucionet ligjzbatuese, ndaj kategorisë së zyrtarëve të lartë në vend. Së dyti, ky ndryshim i Kodit Penal do të rikrijonte mundësinë e hetimit e të gjithë atyre çështjeve të paheturara apo gjykuara më parë, ndaj politikanëve. Së treti, kjo nismë mundëson rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies, si dhe duke mos pasur më parashkrimin si mburojë, nisma shërben gjithashtu për të parandaluar korrupsionin në sferat e larta të qeverisjes.

IV. VLËRËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar jo vetëm që është në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe me parimet e sanksionuara në të, por në vlerësimin tonë është një instrument ligjor i nevojshëm për të realizuar qëllimin e transparencës dhe llogaridhënies të zyrtarëve më të lartë të shtetit të veshur me pushtet. Synimi i Projektligjit

është që për krimet e korrupsionit apo krimet të organizuar, këta zyrtarë të lartë apo ish-zyrtarë të mos kenë mundësi të fshihen pas parashkrimit, (pra, shuarjes së mundësisë për ndjekje penale pas kalimit të një afati kohor të caktuar nga çasti i ngjarjes / veprës penale), por të trajtohen ndryshe nga qytetarët e thjeshtë, duke patur një pozitë procedurale më të rënduar.

Ne gjykojmë se ky propozim është në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe nuk çënon parimin kushtetues të barazisë së shtetasve para ligjit (Neni 18 i Kushtetutës), sepse Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në Nenin 17 të saj parashikon se:

“1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”.

Heqja e parashkrimit për krimet e korrupsionit dhe krimet të organizuar ndaj politikanëve dhe zyrtarëve të lartë që kanë apo që kanë mbajtur poste të larta, nuk çënon parimet Kushtetuese sepse vetë neni 17 i Kushtetutës e parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtave dhe lirive, nëse ato miratohen me ligj dhe për një interes publik. Kushti tjetër, është që gjendja që dikton kufizimin e të drejtave dhe lirive, të jetë në përpjesëtim me situatën që e ka diktuar atë. Për të qënë gjithashtu brenda kornizës të përcaktuar nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Projektligji ka parashikuar gjithashtu se ky kufizim i lirive të mos jetë i përhershëm dhe absolut, por të kufizohet për një periudhë kohore 15-vjeçare, me efekt deri në 31.12.2037.

Siç pranohet gjerësisht, niveli i korrupsionit në vend është një nga problemet më madhore që mbart sot shoqëria shqiptare, ndaj kufizimi i këtyre lirive të një kategorie të vogël individësh, gjykojmë se është tërësisht proporcional, i përgjigjet interesit të përgjithshëm dhe rrjedhimisht nuk çënon parimet kushtetuese.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me ndonjë *acquis* të Bashkimit Europian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban gjithsej 2 nene.

Neni i parë, është neni që kryen shtimin e një dispozite të re në Kodin Penal. Konkretisht, tek neni ekzistues me nr. rendor 67, i titulluar “Mosparashkrimi i ndjekjes penale”, propozohet të shtohet një dispozitë e re me këtë përmbajtje:

“Nuk i nënshtrohen parashkrimit, veprat penale dhe akuzat penale të korrupsionit dhe të krimet të organizuar, kundër Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, Ministrit, Kryetarit të Kuvendit, Kryetarit të Bashkisë Tiranë, drejtuesit e institucioneve qendrore përgjegjëse për prokurimet publike dhe

koncesionet, si dhe ish-funksionarëve të sipërpërmendur. Kjo dispozitë i shtrin efektet e saj deri në datë 31.12.2037”.

Më konkretisht, nëpërmjet kësaj shtese në Kodin Penal, arrihet të hiqet pengesa e parashkrimit për ndjekjen penale lidhur me akuzat e korrupsionit dhe krimin të organizuar ndaj subjekteve të posaçme si, Kryeministri apo Zëvendëskryeministri, Ministri, Kryetari i Kuvendit, Kryetari i Bashkisë Tiranë, drejtuesit e institucioneve qendrore përgjegjëse për prokurimet publike dhe koncesionet, të tilla si Agjencia e Prokurimit Publik (APP), Komisioni i Prokurimit Publik (PKK), apo Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), si dhe ish-funksionarët që kanë mbajtur këto detyra në të shkuarën.

Neni i dytë i Projektligjit parashikon dispozitën e zakonshme për hyrjen në fuqi të ligjit, 15-ditë pas botimit në Fletoren zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij ligji janë Ministria e Drejtësisë, SPAK, institucioni i Prokurorisë, Gjykatat, si dhe institucionet e tjera ligjzbatuese të cilat kanë për detyrë zbatimin e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga grupi i deputetëve të opozitës të cilët kanë nënshkruar projektaktin.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Nuk vlerësojmë që ky projektligj mund të ketë ndonjë efekt financiar për buxhetin e shtetit.

D E P U T E T Ë T